



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/90

Datë: 01.06.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 10 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 1 qershor 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M P R E L I M I N A R

1. Aprovohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit dhe Objekteve të evidentuara ne Certifikatat mbi të drejtat e pronës Nr. P-71914059-06035-0, O-71914059-06035-0-293-1 dhe O-71914059-06035-0-293-2 me pronar "Banka Themelore e Bankës së Lubjanës në Prishtinë" të cilat ndodhen në Zonën Kadastrale Prishtinë, Komuna Prishtinë, për nevoja të Qeverisë së Republikës së Kosovës, sipas tabelës së bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Obligohet Departamenti i Shpronësimit/MMPH që brenda 5 (pesë) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij vendimi preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e paluajtshmërisë të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej 10 ditëve të punës pas miratimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Kosovës, si dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.
3. Kundër këtij vendimi apo cilës do pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në Gjykatën Kompetente, subjekti kërkues dhe cili do person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky vendim.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (MMPH), Ministria e Financave dhe Ministria e Administratës Publike.
5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/90

Datë: 01.06.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 1 qershor 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Task-Forca e cila ka për qëllim anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Institucionet/Mekanizmat Ndërkombëtare të Kulturës.
2. Task-Forca do të përbëhet me nga 1 (një) përfaqësues prej:
 - 1.1. Ministrisë Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kryesues;
 - 1.2. Presidencës;
 - 1.3. Zyrës së Kryeministrit;
 - 1.4. Komisionit për Punë të Jashtme të Kuvendit të Republikës së Kosovës;
 - 1.5. Ministrisë së Punëve të Jashtme;
 - 1.6. Ministrisë së Integritimit Evropian;
 - 1.7. Ekspertë sipas nevojës dhe përfaqësues të shoqërisë civile;
3. Task-Forca themelohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe i raporton Zyrës së Kryeministrit sipas nevojës, por jo më pak së një herë në muaj.
4. Task-Forca, në afat prej më së largu një muaj pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, nxjerr rregulloren e brendshme të punës.
5. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit do të shërbej si Sekretariat i Task-Forcës.
6. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen institucionet e cekura në pikën 2. të këtij vendimi.
7. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/90

Datë: 01.06.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 1 qershor 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projekti për komunikim të procesit të liberalizimit të vizave dhe Marrëveshjes Stabilizim Asociimi i dorëzuar nga UNDP, në bashkëpunim me Ministrinë e Integritimit Evropian.
2. Obligohet Ministria e Integritimit Evropian të kontribuoj në realizimin e projektit nga pika 1. e këtij vendimi, në shumë prej 100,000.00 (njëqindmijë) euro.
3. Mjetet nga pika 2. e këtij vendimi ndahen kategoria ekonomike mallra dhe shërbime e Ministrisë së Integritimit Evropian.
4. Obligohet Ministria e Integritimit Evropian dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/90

Datë: 01.06.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 10 të Ligjit Nr. 05/L-071 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 1 qershor 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për miratimin e Programit për Komunitete

Neni 1

Qëllimi

1. Qëllimi i Programit për Komunitete është ndarja e subvencioneve dhe transfereve nga buxheti i ndarë për Zyrën për Çështje të Komuniteteve në Zyrën e Kryeministrit (në tekstin e mëtejshëm: Programi), me qëllim të mbështetjes dhe promovimit të të gjitha komuniteteve në Republikën e Kosovës.

Neni 2

Fushëveprimi

1. Programi zbatohet nga Zyra për Çështje të Komuniteteve (ZÇK) në Zyrën e Kryeministrit dhe nga të gjithë personat fizik apo juridik të cilët janë përfitues eventual të subvencioneve apo transfereve.
2. Buxheti i ndarë për ZÇK-në në Zyrën e Kryeministrit, kategoria subvencione dhe transfere (në tekstin e mëtejshëm: subvencione) shfrytëzohet në pajtim me këtë Program.

Neni 3

Parimet

1. Gjatë procesit të ndarjes së subvencioneve, duhet të respektohen parimet si në vijim:
 - 1.1. Liria e pjesëmarrjes në konkurrim;
 - 1.2. Mos diskriminimi dhe trajtimi i barabartë;
 - 1.3. Transparenca e procedurave të vendimmarrjes, duke ju ofruar të gjithë aplikuesve të dhënat e kërkuara;

- 1.4. Përputhshmëria me objektivat e subvencionit, me efektivitetin e përdorimit të burimeve në bazë të sistemit të konkurrimit dhe kriterëve, që mundësojnë vlerësimin e kërkesave apo projekt propozimeve dhe specifikave teknike e financiare për përzgjedhjen dhe shpërndarjen e subvencionit;
- 1.5. Paanshmëria e shqyrtimit të vendimmarrjes dhe parandalimi i konfliktit të interesit;
- 1.6. Përfundimi i mbivendosjes, që nënkupton ndalimin e financimit të të njëjtit përfitues më shumë se një herë brenda një viti.

Neni 4

Ftesa për propozime për Organizatat jo Qeveritare

1. ZÇK çdo vit shpallë ftesë për propozime me qëllim të përkrahjes financiare të Organizatave Jo Qeveritare, të cilat merren me mbrojtjen, avancimin dhe promovimin e të drejtave të Komuniteteve në Republikën e Kosovës.
2. Ftesa për propozime shpallet një herë brenda vitit në ueb faqen e ZÇK-së, në mediat elektronike dhe të shtypura, dhe të drejtë aplikimi kanë të gjitha OJQ-të e regjistruara në organin kompetent në Republikën e Kosovës, të cilat i plotësojnë të gjitha kushtet për aplikim, të përcaktuara nga ZÇK, në pajtim me këtë Program.
3. OJQ-të i dorëzojnë formularët e plotësuar për aplikim në ZÇK në formë fizike apo elektronike në njërin nga gjuhët zyrtare brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, pas datës së publikimit të ftesës për propozime.

Neni 5

Kushtet për aplikim

1. OJQ-të që aplikojnë në ftesën për propozime të shpallur nga ZÇK, duhet t'i plotësojnë kriteret dhe kushtet si në vijim:
 - 1.1. duhet të jenë të regjistruara në organin kompetent në Republikën e Kosovës;
 - 1.2. duhet ta kenë fushëveprim mbrojtjen, avancimin dhe promovimin e komuniteteve në Kosovë;
 - 1.3. në rast se kërkohet nga ZÇK, duhet të paraqesin dëshmi të burimeve tjera të financimit/mbështetjes nga donatorët e tjerë;
 - 1.4. dokumentacionin e nevojshëm të kërkuar me rastin e shpalljes së ftesës për propozime;
 - 1.5. si dhe kushtet tjera të nevojshme të përcaktuara me rastin e shpalljes së ftesës për propozime.

Neni 6

Komisioni për shqyrtimin e aplikacioneve

1. Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit me Vendim themelon Komisionin për shqyrtimin e aplikacioneve të OJQ-ve (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) të cilat aplikojnë për përfitimin e subvencioneve në ZÇK.
2. Komisioni i lartpërmendur përbëhet nga pesë (5) anëtarë.

Neni 7

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

1. Komisioni ka për detyrë të zhvillojë të gjitha procedurat për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve të dorëzuara nga OJQ-të, dhe të bëjë përzgjedhjen e OJQ-ve fituese të cilat i kanë plotësuar kushtet dhe kriteret e përcaktuara.

2. Komisioni brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh i kryen të gjitha procedurat e shqyrtimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së OJQ-ve fituese.
3. Pas përzgjedhjes së OJQ-ve fituese, Komisioni në afat prej tre (3) ditësh njofton ZÇK-në për listën e OJQ-ve fituese.
4. Komisioni për punën e tij i raporton Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit.

Neni 8

Kriteret për përzgjedhjen e OJQ-ve fituese

1. Komisioni me rastin e shqyrtimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së OJQ-ve fituese, duhet t'i ketë parasysh kriteret si në vijim:
 - 1.1. përvojën dhe kapacitetet e OJQ-së në zbatimin e projekteve paraprake;
 - 1.2. pritshmërinë dhe koston.

Neni 9

Shpallja e OJQ-ve përfituese

1. Pas përfundimit të procedurave të përzgjedhjes, Komisioni shpall listën e OJQ-ve përfituese, të cilën në afat prej tre (3) ditësh e dorëzon në ZÇK, me qëllim të njoftimit dhe publikimit të saj në ueb faqen zyrtare të kësaj Zyre.

Neni 10

Procedura e ndarjes së mjeteve tek OJQ-të përfituese

1. OJQ-së përfituese pas nënshkrimit të marrëveshjes me ZÇK, do t'i ndahen mjetet financiare për zbatimin e projektit në pajtim me këtë Program. Ndarja e mjeteve financiare bëhet pas dërgimit të raporteve të rregullta sipas kërkesës së ZÇK-së, dhe siç parashihet me marrëveshje.

Neni 11

Monitorimi i zbatimit të projekteve

1. Pas përzgjedhjes së OJQ-së për zbatimin e një projekti të caktuar, ZÇK në vazhdimësi bën monitorimin e zbatimit të atij projekti.
2. Përfituesit janë të detyruar të dorëzojnë raport narrativ për ecurinë e projektit, ndërsa 30 ditë pas përfundimit të projektit janë të detyruar të dorëzojnë raportin përfundimtar narrativ, raportin financiar, dhe të ofrojnë dëshmi (kupon fiskal dhe dëshmi tjera) për realizimin e projektit.
3. Në rast se përfituesit nuk i përmbahen kërkesave të lartcekura, do të anulohet marrëveshja e nënshkruar dhe do të ndërmerren procedurat përkatëse ligjore për keqpërdorimin dhe keq menaxhimin e parasë publike.

Neni 12

Auditimi

1. Njësia për Auditim të Brendshëm në Zyrën e Kryeministrit, sipas detyrës zyrtare bënë auditimin e përfituesve lidhur me shfrytëzimin racional të mjeteve financiare.
2. Njësia e Auditimit përgatit raportin me rekomandime, lidhur me të gjeturat e auditimit.

3. Auditimi bëhet edhe nga auditorët e jashtëm në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Neni 13

Fondi për mbështetjen e mediave të Komuniteteve

1. ZÇK shpallë konkurs për aplikim, me qëllim të përkrahjes financiare të mediave të cilat merren me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të Komuniteteve në Republikën e Kosovës.
2. Konkursi publik shpallet një herë brenda vitit në ueb faqen e ZÇK-së, në mediat elektronike dhe të shtypura, dhe të drejtë aplikimi kanë të gjitha mediat e komuniteteve, të cilat i plotësojnë kushtet për aplikim të përcaktuara nga ZÇK, në pajtim me këtë Program.
3. Mediat për Komunitete formularët e plotësuar i dorëzojnë në ZÇK në formë fizike apo elektronike në njërën nga gjuhët zyrtare brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas datës së shpallur të konkursit publik.

Neni 14

Kushtet për aplikim

1. Mediat që aplikojnë në konkursin publik, duhet t'i plotësojnë kushtet si në vijim:
 - 1.1. duhet të jenë të regjistruara në organin kompetent në Republikën e Kosovës;
 - 1.2. duhet ta kenë në fushëveprim mbrojtjen dhe promovimin e komuniteteve në Kosovë;
 - 1.3. në bazë të kërkesës së ZÇK, duhet të paraqesin dëshmi të burimeve tjera të financimit/mbështetjes nga donatorët e tjerë;
 - 1.4. dokumentacionin e nevojshëm të kërkuar me rastin e shpalljes së konkursit publik;
 - 1.5. si dhe kushtet tjera të nevojshme të përcaktuara me rastin e shpalljes së konkursit publik.

Neni 15

Komisioni për shqyrtimin e aplikacioneve

1. Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit me vendim themelon Komisionin për shqyrtimin e aplikacioneve të Mediave për Komunitetet.
2. Komisioni nga paragrafi 1 i këtij neni përbëhet nga pesë (5) anëtarë.
3. Komisioni për punën e tij i raporton Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit.

Neni 16

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

1. Komisioni ka për detyrë zhvillimin e të gjitha procedurave për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve të dorëzuara nga Mediat, dhe bënë përzgjedhjen e Mediave fituese të cilat i kanë plotësuar kushtet dhe kriteret e përcaktuara me këtë Program.
2. Komisioni brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh kryen të gjitha procedurat e shqyrtimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së Mediave fituese.
3. Pas përfundimit të procedurave të përzgjedhjes, Komisioni në afat prej tri (3) ditësh njofton ZÇK-në me listën e Mediave përfituese.

Neni 17
Kriteret për përzgjedhjen e mediave fituese

1. Komisioni me rastin e shqyrtimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së Mediave fituese, duhet t'i ketë parasysh kriteret si në vijim:
 - 1.1. përvojën dhe kapacitetet e medias në zbatimin e projekteve paraprake;
 - 1.2. pritshmërinë dhe koston.

Neni 18
Shpallja e Mediave përfituese

1. Pas përfundimit të procedurave të përzgjedhjes, Komisioni shpall listën e mediave përfituese, të cilën e dorëzon në ZÇK, me qëllim të njoftimit dhe publikimit të saj në ueb faqen zyrtare të Zyrës.

Neni 19
Procedura e ndarjes së mjeteve tek mediat përfituese

1. Mediat përfituese pas nënshkrimit të marrëveshjes me ZÇK, do t'i ndahen mjetet financiare për zbatimin e projektit pas dërgimit të raporteve të rregullta sipas kërkesës së ZÇK-së, dhe siç parashihet me marrëveshje.

Neni 20
Monitorimi i zbatimit të projekteve

1. Pas përzgjedhjes së Mediave për zbatimin e një projekti të caktuar, ZÇK në vazhdimësi bën monitorimin e zbatimit të atij projekti.
2. Mediat përfituese obligohen të dorëzojnë raport narrativ për ecurinë e projektit, ndërsa 30 ditë pas përfundimit të projektit obligohen të dorëzojnë raportin përfundimtar narrativ, raportin financiar, dhe të ofrojnë dëshmi (kupon fiskal dhe dëshmi tjera) për realizimin e projektit.
3. Në rast se mediat përfituese nuk i përmbahen paragrafit 1. dhe 2. të këtij neni, do të anulohet marrëveshja e nënshkruar dhe do të ndërmerren procedurat përkatëse ligjore për keqpërdorimin dhe keq menaxhimin e parasë publike.

Neni 21
Ndarja e subvencioneve dhe granteve për personat fizik dhe juridik

1. ZÇK ndan subvencione për personat fizik dhe juridik, me qëllim të realizimit të kërkesave dhe projekteve.
2. Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit, me propozimin e ZÇK-së themelon Komisionin për shqyrtimin e kërkesave dhe projekteve për ndarjen e subvencioneve për personat fizik dhe juridik.
3. Komisioni përbëhet nga tre (3) anëtarë.
4. Komisioni bën shqyrtimin e të gjitha kërkesave nga personat fizik dhe juridik, të cilët bëjnë kërkesë në ZÇK për fitimin e subvencioneve.
5. Komisioni për punën e tij i raporton Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit.

Neni 22
Kriteret për aplikimin e personave fizik

1. Të gjithë personat fizik të cilët aplikojnë për fitimin e subvencioneve në ZÇK, duhet t'i plotësojnë kushtet dhe kriteret si në vijim:
 - 1.1. Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
 - 1.2. Dokumentin e vlefshëm identifikues të Republikës së Kosovës;
 - 1.3. Kopjen e llogarisë bankare të njëjës nga bankat në Kosovë;
 - 1.4. Arsyetimi i kërkesës për fitimin e subvencionit apo grantit;
 - 1.5. dokumentet tjera shtesë që dëshmon nevojat tjera për përfitim të grantit apo subvencionit.
 - 1.6. Si dhe kushtet apo kriteret tjera që kërkohen nga ZÇK.

Neni 23
Kriteret për aplikimin e personave juridik

1. Të gjithë personat juridik të cilët aplikojnë për fitimin e subvencioneve në ZÇK, duhet t'i plotësojnë kushtet dhe kriteret si në vijim:
 - 1.1. Të jenë të regjistruar në organin kompetent sipas legjislacionit në fuqi;
 - 1.2. Kopja e dokumentit identifikues të personit të autorizuar që përfaqëson personin juridik;
 - 1.3. Kopjen e llogarisë bankare në njëjën nga bankat në Kosovë;
 - 1.4. Arsyetimin e kërkesës për fitimin e subvencionit;
 - 1.5. Dëshminë e burimeve të tjera të financimit/mbështetjen nga donatorët tjerë;
 - 1.6. Certifikatën valide të numrit fiskal.
 - 1.7. Si dhe kushtet apo kriteret tjera që kërkohen nga ZÇK.

Neni 24
Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

1. Komisioni ka për detyrë zhvillimin e te gjitha procedurave për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve të dorëzuara nga personat fizik dhe juridik në ZÇK.
2. Komisioni mblidhet së paku një herë në tre (3) muaj për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për fitimin e subvencioneve.

Neni 25
Monitorimi i zbatimit të projekteve

1. Pas përfitimit të subvencioneve nga personat fizik apo juridik, ZÇK në vazhdimësi bën monitorimin e zbatimit të këtyre projekteve.
2. Përfituesit janë të detyruar të dorëzojnë raport narrativ për ecurinë e projektit, ndërsa 30 ditë pas përfundimit të projektit janë të detyruar të dorëzojnë raportin përfundimtar narrativ, raportin financiar, dhe të ofrojnë dëshmi (kupon fiskal dhe dëshmi tjera) për realizimin e projektit.
3. Në rast se përfituesit nuk i përmbahen paragrafit 1. dhe 2. të këtij neni, do të anulohet marrëveshja e nënshkruar dhe do të ndërmerren procedurat përkatëse ligjore për keqpërdorimin dhe keq menaxhimin e parasë publike

Neni 26
Konflikti i interesit

1. Në rast se me ndonjërin nga anëtarët e Komisionit ekziston konflikti i interesit me rastin e ndarjes së subvencionit, ai anëtar për atë rast ndërrohet dhe caktohet një tjetër anëtar ad hoc për procedurat e përzgjedhjes dhe votimit.
2. Të gjitha rastet e konfliktit të interesit duhet të shmangen në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Neni 27
Ndryshimi dhe plotësimi i Vendimit

1. Ky vendim ndryshohet dhe plotësohet sipas nevojës, me propozim të Zyrës për Çështje të Komuniteteve në Zyrën e Kryeministrit.

Neni 28
Hyrja në fuqi

1. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryeministri i Republikës së Kosovës.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/90

Datë: 01.06.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, bazuar në shkresën me nr. prot. 1737 të datës 27.05.2016, në mbledhjen e mbajtur më 1 qershor 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Raporti i Komisionit Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Dëshmorit të Kombit, Invalidit, Veteranit, Pjesëtarit apo të Internuarit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.
2. Evidenca e prezantuar nga Komisioni në Raportin nga pika 1. e këtij Vendimi, miratohet si listë e pa përmbyllur e verifikimit të personave të kategorizuar sipas Ligjit Nr. 04/L-261 për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.
3. Lista përfundimtare e verifikimit për të gjitha kategoritë e përcaktuara sipas Ligjit Nr. 04/L-261, si dhe çështjet tjera që ndërlidhen me këtë proces, mbetet të shqyrtohen dhe miratohen në të ardhmen.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/90

Datë: 01.06.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 1 qershor 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Raporti Tremujor mbi zbatimin e Programit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA) gjatë periudhës janar-mars 2016, i hartuar nga Ministria e Integritimit Evropian.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/90
Datë:01.06.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 1 qershor 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen Raportet gjithëpërfshirëse mbi zbatimin e Kornizës Strategjike për Reformën e Administratës Publike për vitin 2015:
 - 1.1. Raporti mbi zbatimin e Planit të Veprimit për zbatimin e Strategjisë për Modernizimin e Administratës Publike;
 - 1.2. Raporti mbi zbatimin e Planit të Veprimit për zbatimin e Strategjisë për Rregullim më të Mirë, dhe
 - 1.3. Raporti mbi zbatimin e Planit të Veprimit për zbatimin e Strategjisë Planifikim të Politikave dhe Koordinim.
2. Obligohen të gjitha institucionet kompetente për zbatimin e obligimeve që dalin nga Raportet nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë